



## NEWSLETTER

Janar 2023

Nr.1

### Promovohet projekti "Liria e shprehjes në UE: Harmonizimi i legjislacionit kombëtar të medias me legjislacionin e BE-së dhe standardet e medias".



Në organizim të Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe Ministrisë së Shoqërisë Informative dhe Administratë më 25 janar u mbajt promovimi i projektit "UE për Lirinë e Shprehjes: Harmonizimi i Legjislacionit Kombëtar të Medias me Ligjin e UE-së dhe Standardet Evropiane të Medias", qëllimi i së cilës është harmonizimi i legjislacionit kombëtar të medias me Direktivën e rishikuar të Shërbimeve Mediatike Audiovizuale dhe standardet evropiane të medias.

Në këtë manifestim fjalë hyrëse mbajtën ambasadori evropian Dejvid Gir, ministri për shoqëri informatike dhe administratë, Admirim Aliti, ministrja e kulturës Bisera Kostadinovska-Stojčevska dhe drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dr. Zoran Trajčevski. Siç theksoi drejtori Trajčevski, zhvillimi i shpejtë i teknologjisë dhe shfaqja e mediave të reja ndryshuan në mënyrë drastike mënyrën e pranimit të informacionit dhe përmbajtjeve të tjera, dhe dallimet ndërmjet mediave tradicionale dhe atyre të reja janë të shumta dhe nuk mund të zbatohet e njëjta kornizë rregullative. Nga aty, sipas rregullores së re evropiane që trajton këto çështje, duhet të bëhen ndryshime në ligjet maqedonase në fushën e mediave. Pas miratimit të ligjeve të harmonizuara, ASHMA sipas nevojave do të ndryshojë ato ekzistuese dhe do të miratojë akte të reja nënligjore.

Në debatin kushtuar peizazhit aktual mediatik në vend dhe kërkesave të vendosura (imponuara) nga rregullorja evropiane, foli mr, Emilija Janevska, udhëheqëse e Sektorit për çështje programore. Ajo vuri në dukje sfidat që qëndrojnë përpara Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale pas harmonizimit të ligjeve vendase të medias me Direktivën e rishikuar të Shërbimeve Mediatike Audiovizuale, Aktin e Shërbimeve Dixhitale dhe Aktin e Tregjeve Dixhitale.

### Shpenzimet e Drejtorit të Agjencisë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2022

Në pajtim me përkushtimin për transparencë dhe llogaridhënie, si dhe me praktikën e krijuar tashmë të publikimit të shpenzimeve të drejtorit dr. Zoran Trajčevski, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale më 5 janar informoi publikun se në gjysmën e dytë të vitit 2022, me datën 31 dhjetor gjatë kryerjes së detyrës ka bërë shpenzime në vlerë të përgjithshme prej 309.245,00 denarë dhe atë për artikujt (pozicionet) në vijim:

- Shpenzime për përfaqësim (shërbime catering me përfaqësues të ambasadave dhe partnerë afarist) – 53.990,00 denarë;
- Celular zyrtar – 15.883,00 denarë;
- Shpenzimet gjatë udhëtimeve jashtë vendit – 239.372,00 denarë (126.838,00 denarë për bileta avioni dhe 112.543,00 denarë për akomodim në hotel dhe shpenzime të udhëtimit).

### NJOFTIMET PUBLIKE

Në muajin janar, Agjencia ka reaguar në disa raste për ofendimet verbale dhe ofendimet e drejtuara ndaj gazetarëve.

Më 17 janar, u dënua ashpër etiketimi i politikës redaktuese të mediave të caktuara nga ana e kryeministrit Dimitar Kovačevski dhe u theksua se bartësit e funksioneve publike duhet të përmbahen nga shprehja e qëndrimeve personale, subjektive që cenojnë lirinë e mediave. Në vend që të përdorin narrativa që diskreditojnë dhe bëjnë presion mbi mediat, ato duhet të jenë shembull i sjelljes së përgjegjshme dhe profesionale. Në të njëjtën kohë, Agjencia rikujtoi se roli i mediave është të informojë dhe të ngrejë çështje që janë objekt i interesit publik, prandaj të gjithë faktorët relevantë në vend duhet të bëjnë çdo përpjekje për të siguruar një mjedis të favorshëm për forcimin e lirisë së medias të redaksisë dhe pavarësisë editoriale.

Më 16 janar, më së shumti u dënuan ashpër kërcënimet drejtuar punonjësve të televizionit Kanal 5 nga një person fizik në rrjetin social "Facebook". Në njoftim thuhet se sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve janë të papranueshme dhe të gjitha organet kompetente duhet të ndër marrin masat e nevojshme për të krijuar një mjedis në të cilin do të ekzistojnë media profesionale, të lira dhe të pavarura. Për të mundur zhvillimin demokratik të shtetit, është thelbësore që gazetarët të jenë të sigurt në çdo kohë dhe t'u mundësohet kryerja e punës së tyre pa ndërprerje, gjegjësisht të jenë në gjendje në kohë e duhur të informojnë qytetarët për raste të ndryshme sociale, pa kërcënime dhe frikësim.



Më 16 janar, u dënua ashpër deklarata e kryetarit të BDI-së Ali Ahmeti, i cili televizionet Telma dhe Alfa i etiketoi si armiq të shqiptarëve. Agjencia theksoi se personat publik, dhe veçanërisht kryetarët e partive politike, duhet të jenë të vetëdijshëm se liria e shprehjes nënkupton dhe përgjegjësi. Në vend që të përdorin komunikim të papërshtatshëm, ata duhet të shërbejnë si shembull dhe të tregojnë nivelin më të lartë të respektit për një nga shtyllat kryesore të demokracisë – median.

Në lidhje me pengimin e ekipeve gazetareske të "Radio Lider" dhe "Kurir" për të përcjellë vizitën e përfaqësuesve të qeverisë në fabrikën "Pekabesko", Agjencia më 11 janar nëpërmjet njoftimi publik apeloj se pengimi i punës së gazetarëve paraqet kërcënim për lirinë dhe të drejtën për informim. Punonjësit e medias në asnjë moment nuk duhet të pengohen në kryerjen e detyrave të tyre të punës dhe duhet t'u jepet qasje e lirë në të gjitha ngjarjet, duke pasur parasysh rolin e tyre në hapjen e çështjeve me interes publik dhe sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike.

Në lidhje me vendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme për të shpenzuar 100.000 euro për fushatat që synojnë promovimin e kryesimit të OSBE-së, Agjencia më 5 janar, ndër të tjera theksoi se shfrytëzimi (përdorimi) i mjeteve buxhetore për reklama në media është shkelje e nenit 102 të Ligjit për Shërbimet Mediatiqe Audio dhe Audiovizuale. Për ngjarje të tilla e të ngjashme që janë me rëndësi të madhe për shtetin, qytetarët jo vetëm që kanë të drejtë por edhe duhet të informohen, por në mënyra të tjera, jo përmes shpenzimit të mjeteve buxhetore.

## Mbikëqyrja e transmetuesve dhe operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik

### Transmetuesit

Mbikëqyrje të rregullta programore dhe administrative për disa detyrime ligjore - mbikëqyrja e respektimit të rregullave gjatë transmetimit të komunikimeve komerciale audiovizuale, mbrojtja e audiencës së mitur, përdorimi i shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar dhe votimi telefonik, transmetimi i lojërave të fatit dhe ofrimi i kuizeve apo formave të tjera të pjesëmarrjes në çmim, transmetimi ditor të paktën 12 orë të programeve televizive TV dhe transmetimi ditor i të paktën 40% të programeve të krijuara burimore, publikim të impresium, informacioni që duhet të vihet në dispozicion të përdoruesve dhe publikimi i identifikimit të transmetuesit, janë kryer në programet televizive të Shërbimit Publik - MRT 1, MRT 2, MRT 3, MRT 4 dhe MRT 5. Gjatë mbikëqyrjeve është konstatuar se në kundërshtim me nenin 55 paragrafi (5) të LSHMAAV, në pjesë të programit të MRT 2 të transmetuar më 4 janar, u plasuan produkte pa treguar qartë se programi përmbante marketingun e produktit.

Pas skadimit të afatit për harmonizim ligjor me masat e shqiptuara vërejtje publike mbikëqyrje kontrolli dhe administrativ për dispozita të ndryshme ligjore është kryer ndaj ndaj TV Dibra, TV Plus, TV Protel, TV Shutel, TV Iris dhe TV Kanal Festa . Nga mbikëqyrja u konstatua se TV Dibra ende nuk transmeton së paku 30% të programeve të krijuara burimor si vepra audiovizuale maqedonase dhe as gjysmën e minimumit ligjor në periudhën nga ora 7:00 deri në orën 19:00, ndërsa TV Kanal Festa nuk ka siguruar informacionin që duhet të vihet në dispozicion të përdoruesve.

### Operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Lidhur me detyrimin e operatorëve të JRRPMM-së, në paketën programore që e ritransmetojnë detyrimisht dhe pa pagesë të sigurojnë shërbimet programore të shërbimit publik të transmetimit, si dhe për detyrimet për regjistrimin e shërbimeve programore në Agjenci dhe titrimin e programeve që ritransmetojnë, është kryer mbikëqyrja e rregullt programore ndaj operatorët Inel International, Telekabel, Pet Net dhe Global Sat. Gjatë mbikëqyrjes nuk janë konstatuar shkelje. Në operatorin Kablekall nga Kërçova është kryer mbikëqyrje e kontrollit programor nga i cili ka rezultuar se në tërësi ka vepruar sipas masës së shqiptuar më parë, e dhënë për mosrespektim të detyrimit për ritransmetim të shërbimit programor pa rregulluar të drejtën autoriale dhe të drejtat e përafërta.

### Masat e shqiptuara vërejtje publike

Këshilli i Agjencisë në seancën e 1-rë, mbajtur më 9 janar, miratoi shtatë aktvendime për shqiptimin e masës vërejtje publike për TV Spektra, Radio Student FM 92.9, TV Uskana Media, Radio Maria dhe Radio UGD FM. Ndaj TV Spektra janë shqiptuar dy masa vërejtje publike për transmetimin të servisi programor në kohë të papërshtatshme dhe me sinjalizim të gabuar paralajmërues dhe mostransmetim të së paku 30% të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase. Radio Studenti FM 92 janë shqiptuar dy masa vërejtje publike për mospublikimin e shenjës së vet identifikuese dhe mosdhënien e informacionit që identifikon autorët dhe redaktorët e lajmeve të transmetuara në radio, si dhe origjinën dhe datën e prodhimit të tyre. TV Uskana Media i është shqiptuar vërejtje publike për mostransmetim të së paku 30% të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, ndërsa Radio Marija-Blagovest dhe Radio UGD FM është shqiptuar masë vërejtje publike për mosdhënien e informacionit që duhet të vihet në dispozicion të përdoruesve.

